



## PROCESVERBAL IX/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IX(nëntë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

---

**Vendi:** KK Suharekë  
**Zyra:** Salla e Bordit të Drejtorëve  
**Data:** 18.09.2024  
**Ora :** 13:00

---

### **Prezentë:**

**Z. Bexhet Kuçi - Kryesues**  
z. *Urim Suka*  
znj. *Bulëza Kuçi*  
znj. *Sanie Kuçi Rexhepaj*  
znj. *Fidaije Kukaj*  
z. *Dardan Berisha*  
z. *Liridon Fandaj*

### **Të pranishëm tjerë:**

**Nënkryetarja e Komunës znj.Mihrije Suka**  
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore  
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim  
Përfaqësues i OSBE-së  
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2025;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga taksa në aktivitet;**

**Dardan Berisha** - përshëndet të pranishmit. Unë kërkoj ose të jetë një pikë shtesë në rend dite ose të diskutohet. Bëhet fajle për një dem material që i është bërë Florim Avdi Destanit në Delloc, ku iu ka djeg komplet shtëpia. A duhet të futet si pikë e rendit të ditës veçantë apo si kanë shku tjerat?

**Kryesuesi** - nga praktika që kemi pas prej dy rasteve, është bashkëngjitur kërkesa, raporti dhe e adreson për pikë të rendit të ditës. Gjithëashtu ZKF duhet me i siguruar mjetet .

**Enver Shabani** - Dardani e përmendi që fondi emergjent nuk ekziston por ky nuk është rast i vetëm. Para disa jave ka ndodh edhe në Budakovë ku Shefket Kokollarit iu ka djeg shtëpia komplet. Ai është me gjendje të rëndë ekonomike, veteran i luftës dhe ai ka bërë të njëjtën kërkesë. Patjetër duhet të formohet një komision që bën vlerësimin e dëmeve nga zjarri. Pastaj pas vlerësimit nga ana komisionit shkon në Asamble si pikë në rend dite dhe atje votohet. Bëhet procesverbal dhe kur të votohet bashkë me procesverbalin shkon në agjencinë e menaxhimit të emergjencave.

**Ardian Kotorri** - hera e fundit që e kemi bërë mbështetjen, mjetet janë marrë prej Drejtorisë së Bujqësisë, kategorija e subvencioneve. Është problem nëse vazhdojmë në këtë formë dhe kisha thënë që të ndjeket procedura e Agjencionit të emergjencave sepse kemi probleme dhe vetëm te drejtoria ime përmbartuesi i ka marrë 40-50€.

**Enver Shabani** - ne e kemi diskutuar edhe me Kryetarin mundësinë me përdor mundësinë përmes Halil Kastratit. Do ta diskutojmë me Halilin mundësisht me i ndërto këto dy shtëpi.

**Dardan Berisha** - unë e ngrita shqetësimin që të diskutohet dhe formën ligjore ai le ta përcjell sikur të tjerët.

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet rendi i ditës**

### **Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - pyet nëse ka vërejtje.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - kam vërejtje te pjesa te të pranishmit kush kanë qenë mbledhjen e kaluar. Unë kam mungu dhe këtu po figuron emri im, gjithashtu edhe Kryetari gjithmonë është sipas procesverbalit pjesë e mbledhjeve por që ai rrallëherë është pjesë e takimeve. Kërkoj të evidentohen saktë personat që kanë marrë pjesë, çoftë anëtarët e KPF-së, çoftë të pranishmit tjerë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim procesverbalin me vërejtjen që u tha.

**Unanimisht Miratohet**

### **Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e të hyrave dhe të dalurave të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2025;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - përshëndet të pranishmit. Siq kam thënë edhe në takimin që kemi pas nën organizimin OSBE-së,më vje mirë që në krahasim me vitet paraprake të hartimit dhe planifikimit të buxhetit kemi një dokument që është i përgatitur shumë më mirë se më herët.Në diskutimin që unë e kam pas në takimin e organizuar nga OSBE unë i kam ngrit disa shqetësime me qëllimin e vetëm që dokumenti me qenë më i mirë dhe pas analizës që unë i kam bërë mbi bazën e shqetësimeve që i kam ngrit,rezulton që shumicën e atyre propozimeve ju prap i keni marrë parasysh. Por pak a shumë në disa vende ku është planifikua ky buxhet nuk i qartëson shumë gjëra,sidomos të ndriçimi,te kanalizimet. Te hapësirat për varreza prap i keni parapa 230.000€ dhe këtë vit është një kontratë 480.000€ dhe atje po ndodh vetëm beton.Për hapësirat për varreza në Bllacë nuk pash asgjë në buxhet dhe mendoj që është mangësi. Duke marr parasysh këtë përpjekje që e keni bërë,vota ime do të jetë votë abstenimi por fjalën kryesore e japim në Asamble.

**Liridon Fandaj** - ne si subjekt politik edhe atë ditë patëm disa vërejtje që ky buxhet nuk është me kërkesa të qytetarëve ose të paktën në dëgjimet publike që janë bërë. Ky buxhet ka qenë një buxhet elektoral dhe është i ndanë në disa fshatra ku një pjesë e investimeve nuk është në proporcion me numrin e banorëve ku me një pjesë vendosen investime kapitale ku në kuadër të komunës është kanalizimi dhe është i shpërndamë shumë aty ku partia në pushtet në nivel lokal e ka elektoratin e vet.Ne nuk e mbështesim këtë buxhet.

**Dardan Berisha** - më së paku është e drejtë me bo politikë me buxhet duke shku drejt zgjedhjeve.

Unë e pranoj që nuk kam qenë në asnjë dëgjim publik. Të gjitha procedurat ligjore ekzekutivi e ka obligim me i përcjell dhe i ka përcjell deri sa ka ardhë qarkorja e dytë. Por ne si asamblist nëse kërkojmë,duhet me dal jashtë dhe jo vetëm për fshat të vetin.Ti ja ke shtu një rrugë fshatit tënd por dikujt tjetër ja ke hek. Buxheti prej 2017 sa jam unë në Asamble është i hartuar mirë por ka gabime dhe janë të vogla.

Unë jam pro këtij vendimi.

**Kryesuesi** - të ulemi ta bisedojmë deri sa të votohet sepse ka hapësirë edhe me lëvizje.E cekët shkollën “7 Marsi” por ajo shkollë nuk mund të bëhet me parë të Komunës.

**Urim Suka** - Dardani në disa raste për bindjen time tha disa pasaktësi. Më së paku unë po bëj politikë sepse unë e vlerësova kontributin tuaj dhe nëse jemi në zgjedhje,unë duhet kritikën me pas shumë më të madhe se sa me vlerësua. Unë po e shoh dokumentin, krahason me vjet që ky dokument është tjetër. Por nuk thash që nuk ka gabime,ato gabime do ti themi edhe në Asamble. Propozimet që i kam bërë unë fare nuk kanë qenë për fshatin Bllacë por propozimet kanë qenë për Nishor dhe Javor dhe ju i keni marrë parasysh edhe unë i vlerësoj por politikë nuk bëra fare.

**Dardan Berisha** - politikë unë mendoj kur ti shkon m’i ja hek rrugën dikujt tjetër dhe me fut një tjetër. Pse nuk kërkon me u shtu buxheti për fshatin Nishor dhe me fut atë rrugë.

**Urim Suka** - unë kam propozu me i shtu disa rrugë por unë s’kam bërë propozime me i heq. Nëse këta i kanë heq është çështje tjetër.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**4 për,1 kundër,2 abstenime**

**Miratohet Pika 2**

**Liridon Fandaj** - unë e kërkoja prapë fjalën dhe desha të diskutoj për pjesën që ti the që duhet me votu. Nëse ti ke qenë pjesë e një dëgjimi publik dhe asnjë kërkesë e atyre qytetarëve nuk është marrë për bazë,atëherë nuk duhet m’u votu. Ka qenë diçka shumë jetike për qytetarët dhe që ata kërkojnë të kenë vetëm ujë.

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - a ka mundësi Drejtoria e Shërbimeve të Pronës me na sjell një raport rreth zbatimit të kontratës? Nuk jam e sigurve por kontrata përmban edhe disa obligime që ka pas operatori me iu përmbajt gjatë kësaj periudhe kohore. Sa kam informacion deponitë legale për me u bë legale me vendim të Asamblesë për me u dhënë në shfrytëzim duhet me pas pëlqim mjedisor. Atëherë ka pas pëlqim mjedisor për shkak se deponia është në kuadër të zonës industriale mirëpo vendimin për atë plan rregullues ne e kemi shfuqizuar dhe me këtë rast është shfuqizuar edhe pëlqimi mjedisor që është dhënë prej ministrisë. Nuk është vepru drejt si Komunë për me dhënë një deponi legale nëse nuk ka pëlqim mjedisor nga ana e ministrisë.

**Urim Suka** - për çështjen e deponisë legale kemi ngrit shqetësime sepse kanë ardhë ankesa edhe te ne dhe e kemi njoftu edhe Asamblenë komunale. Në shqetësimet që unë i pata ngrit, Drejtori ka thënë që kjo është një kontratë që është edhe një vit dhe kjo ka me skadu dhe ka me u kthi në gjendjen e njejtë dhe mos me u dhënë më sepse është e mbushur. Këtu na ka ardhë propozimi me vazhdu edhe për 15 vite. Unë nuk e kam vizitu dhe do ta marr obligimi që sot me vizitu zonën industriale mirëpo duke i marrë parasysht këto dhe përgjigjen që atëherë ma ka dhënë drejtori, unë jam fuqishëm kundër. Nuk e di a ka ndonjë ambient tjetër ku mundet me u bë një deponi tjetër dhe nuk i kish pengu askujt. Është mirë me sjell një raport se çka ka ndodh me atë kontratë.

**Dardan Berisha** - unë e kam vizitu dje atë deponi. Ajo deponi është mbush shumë dhe është keq por ne për deri sa nuk kemi një deponi tjetër, a e din sa është ngarkesë për qytetarin se ku do ti hudh mbeturinat. E di që i ka kalu kontrata dhe që ka ankesa aty përball. Ne si Kuvend duhet me vendos dhe duhet me paraqit si rast urgjent. Edhe pse i ka dal kontrata ai le të shkon dhe ta pastron. Gjejeni parcelën dhe ne jemi pro vendimit por nuk ke hapësirë askund.

**Kryesuesi** - është diskutu që është mbush por ka hapësirë dhe 1-3 ha janë në fund të saj dhe për atë është sjell. Kanë hulumtu dhe vend tjetër nuk ka. Keq është por me e mbyll është edhe më keq.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - ministria nuk e pranon pa pëlqim mjedisor.

**Liridon Fandaj** - kjo deponi është për mbetje të ngurta dhe unë edhe në Asamble e kam ngrit si shqetësim sepse disa qytetar janë infektu prej asaj deponie. Nëse dikush e ka menaxhu atë deponi dhe po lejon me gju mbetje të kafshëve aty, është shqetësuese dhe e rrezikshme për qytetarët. Mendoj që kjo deponi duhet me marrë një pëlqim siq e tha edhe Sania dhe pastaj me u destinu se a është edhe për mbetje tjera sepse në vendim e kemi për mbetje inerte. Kush do që e merr duhet me u marr edhe inspeksioni dhe drejtoria përkatëse.

**Avni Bytyqi** - udhëzimi administrativ i MAPL-së i vitit 2015 për organizimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve e obligon komunën që të caktoj lokacionin, gjë të cilën komuna jonë e ka bë në vitin 2015 dhe sa i përket çështjes së pëlqimit mjedisor në bazë të udhëzimit administrativ që unë cekta, nuk e kërkon një gjë të tillë për komunën tonë për arsye se udhëzimi administrativ thotë që komunat të cilat kanë mbi 60.000 banorë janë të obliguar që të marrim një pëlqim mjedisor në MAPL ndërsa ato komuna që janë nën 60.000 banorë leje mjedisore marrin sipas udhëzimit administrativ për lëshimin e lejeve mjedisore që është kompetencë e Drejtorisë së Urbanizmit. Mendoj që deri sa të filloj procedura e ankandit publik, Drejtoria e Urbanizmit ka për obligim që ta konstatoj që a i plotëson kushtet dhe kriteret që të lëshohet leje mjedisore sipas udhëzimit administrativ. Sa i përket përcaktimit të afatit, udhëzimi administrativ thotë që deponitë të cilat i cakton komuna për dhënie në shfrytëzim, nuk lejohen më pak se për 5 vite. Pra, jepen 5 deri 15 vite.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**3 për, 3 kundër**

**Kryesuesi e përdor votën e dyfishtë dhe voton për.**

**Miratohet pika 3**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga taksa në aktivitet;**

**Kryesuesi** - e laboron pikën dhe hap debatin.

**Liridon Fandaj** - është e mirëseardhur kjo për bizneset sepse sidomos rruga “Skënderbeu” është që një kohë të gjatë duke u punu dhe iu ka pengu bizneseve. Për pjesën e rrugës “Brigada 123” është dasht m’i evidentu ato biznese që janë në atë pjesë sepse sot e ndërrojnë një adresë të biznesit për 2.50 € e ndoshta për një biznes 500€ në vit taks është e madhe. Është mirë me i evidentu sepse këtë mund ta shfrytëzoj dikush.

**Avni Bytyqi** - le të del rekomandim prej KPF-së me iu adresu Drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Buxhet dhe me i evidentu bizneset që aktualisht janë,të cilët kanë me i liru.

**Urim Suka** - ku janë duke u zhvillu punimet dhe për shkak të vonesave të implementimit të projekteve,bizneset aty janë dëmtu dhe në parim normal që duhet me pas politika të tilla për me i liru dhe ne nuk jemi kundër. Për mos me pas dilema,ne e kemi pas një propozim më herët që taksën në aktivitet me bo zero dhe ne po e propozojmë prap atë propozim që taksë në aktivitet me qenë zero.

**Dardan Berisha** - unë e di dhe kam qenë kundër atij propozimi dhe prap jam kundër.Tash jemi duke shku në zgjedhje dhe prap po e përdor atë propagandë. 3 milion i ka marrë përmbaruesi dhe ne nuk kemi pare me i implementu shumë projekte prioritet për komunën dhe tash me fal një biznes që ku e di sa të hyrat i ka!Unë jam kundër për m’i fal të gjithë.

**Urim Suka** - e kuptoj Dardanin. Dardani është duke e bërë pozitën e opozitës. Ne këtë që po e ngritim sot,e kemi pas në planin zgjedhor,e kemi bërë pra dy vite kur s’ka pas fushatë dhe prap po e themi sepse është e mirë për njerëzit.Taksa në aktivitet i shërben më së shumti bizneseve të vogla dhe të mesme sepse janë shumë.

**Dardan Berisha** - Një propozim që nuk shkon një herë dhe dy herë,mos e propozo më.Bizneset më të mëdhaja janë në Brigadën 123.Merre një vlerësim prej të gjitha bizneseve dhe nëse është një kosto e vogël edhe unë e qoj dorën.

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin e Urimit.

**3 për, 3 kundër, Nuk kalon propozimi**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**Unanimisht Miratohet pika 4**

Takimi përfundoi: 14:00

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj